

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Magjistratët çojnë sërish në Kushtetuese formulën e re të pagave
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/18/magjistratet-cojne-serish-ne-kushtetuese-formulen-e-r-e-te-pagave/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 20:20:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 19:50:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3809969cba07de6d08fccdb9757f611003d3891905faaf0a40c38ca36985ad9c
TEKSTI	d9e20cc11dc9822632bc524837d1cb9c9c7443abb8ceea72f8e397c8307efe2a
PAMJA	ee6b0284c1fd837b80d9b6166c54ca282e197d84601511b987ce999e5aa3e8f0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a0fb9ec87e67d6baa0cf60c6b90206825a5e6073db5ec58aab4ab60da9f4b92a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d8fd0ed91dbebc864780a4583f7f7de5df5b250232dc1d3996dcf03dc7a10c89
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a0fb9ec87e67d6baa0cf60c6b90206825a5e6073db5ec58aab4ab60da9f4b92a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

Magjistratët çojnë sërish në Kushtetuese formulën e re të pagave

Përfaqësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve theksuan përmes një deklarate të përbashkët se do të kundërshtojnë në Gjykatën Kushtetuese formulën e re të pagave, të miratuar nga mazhoranca socialiste mëngjesin e të premtës. Ndërkohë, kryeministri Edi Rama i ftoi përmes një postimi në llogarinë e tij në X që të negociojnë një tjetër zgjidhje afatgjatë.



nga Edmond Hoxhaj — 42 seconds më parë në Lajme Koha e leximit: 4 min lexim

AA

0



Seanca plenare e Kuvendit të Shqipërisë | Foto: LSA

Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë shprehën qëndrimin e tyre të përbashkët të premtën, më 18 shtator, kundër vendimarrjes së Kuvendit të Shqipërisë. Ky i fundit, me 81 vota të mazhorancës socialiste dhe 3 vota të PSD-së, miratoi në kundërshtim dhe në shkelje të afateve të vendimit të Gjykatës Kushtetuese formulën e re për pagat e magjistratëve, duke i rritur ato me 2%. Në deklaratë theksohet se do të vijohet me ndjekjen e procesit kushtetues lidhur me pagat e magjistratëve.

Sipas përfaqësive vullnetare të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedura parlamentare për miratimin e formulës së re të pagave të magjistratëve që në fillim është karakterizuar nga shkelje të kërkesave kushtetuese, prej miratimit të projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesës së një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesës së konsultimit efektiv dhe dëgjimit tërësisht formal të grupeve të interesit, si dhe nga hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.

"Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magjistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi", citohet në deklaratë.

Shoqatat e vlerësojnë të domosdoshme kërkesën për shfuqizimin e këtij ligji, me argumentin se cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve – i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre – por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas shoqatave, do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magjistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.

"Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar. T'i paraqitet opinionit publik ai atë që ai thë këtij procesi. Ajo

Magjistratët çojnë sërish në Kushtetuese formulën e re të pagave

21:50 | 18/09/2026

KLP tejkalon afatin për verifikimin e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm

18:26 | 18/09/2026

Ekonomia progresiste po jep rezultate

15:18 | 18/09/2026

Nga Lazarati të Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri

07:16 | 18/09/2026

Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve ngre shqetësim për mos zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pagat e magjistratëve

18:43 | 17/09/2026

Vendimi për Kosovën pasqyron përparësitë strategjike të Perëndimit, jo synimin për drejtësi

17:54 | 17/09/2026

lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës”, shtohet në deklaratë, duke nënvizuar se do të përdoret çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.

Mesditën e të premtës, disa orë pas miratimit të projektligjit në Kuvend, kryeministri Edi Rama i ftoi magistratët përmes një postimi në llogarinë e tij në X që të negociojnë për të gjetur një tjetër zgjidhje për pagat.

“Uroj dhe besoj që përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, që nga drejtuesit e dy këshillave dhe me radhë drejtuesit e institucioneve të gjyqësorit, do t’i përgjigjen pozitivisht ftesës për t’u ulur së bashku në një tryezë pune pa humbur kohë, e për të adresuar temën e sistemit të pagave të magistratëve në funksion të një zgjidhjeje të qëndrueshme afatgjatë, e cila i garanton ata përgjithnjë, por njëkohësisht garanton edhe ekuilibrin e përgjithëhershëm të piramidës shtetërore të pagave. Tryeza jonë do të mirëpresë edhe pjesëmarrjen e ekspertëve të Këshillit të Evropës, si edhe kontributin e Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë”, shkroi Rama ndër të tjera.

Gjykata Kushtetuese shfuqizoi në shkurt të këtij viti si të papajtueshme me Kushtetutën formulën e mëparshme të miratuar nga Kuvendi për pagat e magistratëve dhe i la ligjvënësit afat deri më 31 korrik për miratimin e një formule të re.

Vendimi parashikonte gjithashtu një mekanizëm zhblokues, sipas të cilit formula e re e pagave do të përcaktohej nga vetë organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë në rast se Kuvendi nuk vepronte brenda afatit.

Pas përfundimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcaktuan një pagë bazë referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin. Këshillat vendosën gjithashtu kompensimin e asaj që e konsideruan “ulje të fshehur” të pagave nga ligji i mëparshëm, për periudhën nga prilli 2023 deri më 31 korrik 2026.

Ministria e Financave refuzoi ta zbatonte këtë përllogaritje, ndërsa magistratët iu drejtuan SPAK-ut me kallëzim penal dhe Gjykatës Administrative me padi. Gjykata Administrative vendosi në favor të pagesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas formulës së përcaktuar nga këshillat.

Përplasja mes institucioneve të drejtësisë dhe shumicës parlamentare u zhvendos në seancën plenare, ku në orët e para të mëngjesit të së premtës mazhoranca socialiste dhe PSD miratuan projektligjin e ri që përcakton rritjen e pagave të magistratëve me rreth 2%.

Etiketa: DREJTESI Edi Rama Gjykata Kushtetuese Kuvend magistratë paga qeveri

Reforma ne Drejtessi

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontaktoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatesise dhe rregulla te tjera
Letra per redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Sfida PRO](#)